

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR / ZA / TO	KUJTIM GASHI -Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit	DATE DATU M DATE	04.03.2019
		Reference	
NGA / OD / FROM	Avdullah Hoti, Kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së		
SUBJE KTH PREDM ET SUBJE CT	Pyetje parlamentare për përgjigje me shkrim		

Në bazë të Nenit 46 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, shtroj pyetje parlamentare për përgjigje me shkrim nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Kujtim Gashi


Çështja

Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit me Ligjin për Buxhetin e vitit 2017, 2018 dhe 2019, ka paraparë 'Rregullimin e stadiumit të futbollit në Ratkoc të Rahovecit, por që nuk është realizuar.


Për tre vite me radhë nuk ndërmerr masa rreth këtij projekti , i cili bartet nga një vit buxhetor në tjetrin.

PYETJA

Pse nuk është bërë rregullimi i stadiumit të futbollit në Ratkoc të Rahovecit për gjatë këtyre viteve? Çfarë masa do të ndërmerrni për fillimin e këtij projekti dhe kur pritet të filloj realizimi i tij?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR / ZA / TO	Shyqiri Bytyqi-Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	DATE DATU M DATE	04.03.2019
		Reference	
NGA / OD / FROM	Avdullah Hoti, Kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së 		
SUBJE KTI PREDM ET SUBJE CT	Pyetje parlamentare për përgjigje me shkrim		

Në bazë të Nenit 46 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, shtroj pyetje parlamentare për përgjigje me shkrim nga z. Shyqiri Bytyqi, Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë


Çështja:

“Ndërtimi i sallës së edukatës fizike dhe rregullimi i oborrit në shkollën e Mesme të Lartë në Ratkoc-Rahovec”, është një projekt i Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, i cili nuk është realizuar edhe pse është paraparë me Ligjin për Buxhetin, tash e sa vite.

Mungesa e kushteve elementare për zhvillim të aktiviteteve të lira dhe mësimi është shumë shqetësuese dhe ndikon drejtpërdrejtë në suksesin e nxënësve.

PYETJA:

A keni plan konkret për ta zgjidhur këtë çështje? Kur do ta bëni dhe cili është afati kohor i zgjidhjes së këtij problemi?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR / ZA / TO	z. Pal Lekaj-Ministër i Infrastrukturës dhe Transportit	DATE DATUM DATE	04.03.2019
		Reference	
NGA / OD / FROM	Avdullah Hoti Kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje parlamentare për përgjigje me shkrim		

Në bazë të Nenit 46 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, shtroj pyetje parlamentare për përgjigje me shkrim nga Pal Lekaj-Ministër i Infrastrukturës dhe Transportit

Çështja:

Rruga "Tirana" është rrugë në Mitrovicën Veriore në gjatësi prej 300 metra, e banuar kryesisht nga shqiptarët dhe ka nevojë për t'u asfaltuar.

Në amendamentin e bërë nga Grupi Parlamentar i LDK-së, ky projekt është përfshirë në buxhetin e vitit 2018 po ashtu edhe me buxhetin 2019 me titull "Asfaltimi i rrugës Tirana, në Mitrovicën Veriore" me (kodi i projektit 15763). Realizimi i këtij projekti ka ngecur.

PYETJA: Çfarë keni bërë për këtë projekt deri më tani?



REPUBLIC OF KOSOVO
KOSOVSKA REPUBLIKA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOSOVSKA REPUBLIKA

06/2959/00-1538

05.03.2019

Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR / ZA / TO	z. Shyqiri Bytyqi, Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	DATË DATUM DATE	04.03.2019
		Reference	
NGA / OD / FROM	Avdullah Hoti Kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje parlamentare për përgjigje me shkrim		

Në bazë të Nenit 46 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, shtroj pyetje parlamentare për përgjigje me shkrim nga z. Shyqiri Bytyqi, Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Çështja:

Me propozim të Grupit Parlamentar të LDK-së, në buxhetin e vitit 2018 dhe 2019 është përfshirë projekt i ri "Fasadimi i Shkollës Filllore 'Aziz Sylejmani' në Mitrovicë" (kodi i projektit 18470).


Fasadimi i Shkollës Filllore "Aziz Sylejmani" në Mitrovicë është kërkesë e vazhdueshme e prindërve, nxënësve dhe e mësimitdhënësve të kësaj shkolle. Fasada e vjetër është e paqëndrueshme dhe e dëmshme dhe paraqet rrezik për fëmijët dhe stafin mësimitdhënës të kësaj shkolle

PYETJA:

Çfarë veprime keni ndërmarrë për këtë projekt deri më tani?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly



PËR / ZA / TO	z. Skënder Reçica, Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale	DATE DATUM DATE	04.03.2019
		Reference	
NGA / OD / FROM	Avdullah Hoti Kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje parlamentare për përgjigje me shkrim		

Në bazë të Nenit 46 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, shtroj pyetje parlamentare për përgjigje me shkrim nga z. Skënder Reçica, Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale

Çështja:

Ndërtimi i kulmeve në tri (3) shtëpi në Kodrën e Minatorëve në Mitrovicë është nevojë imediate e tri familjeve. Ndihamat që marrin këto familje, nuk ju mjaftojnë as për nevojat elementare. Me propozim të Grupit Parlamentar të LDK-së, ky projekt është përfshirë në buxhetin e vitit 2018 por nuk është realizuar nga institucionet përkatëse, e po ashtu edhe me buxhetin e vitit 2019,.

Titulli i projektit në bazë të buxhetit 2019 është, *“Ndërtimi i kulmeve në 3 shtëpi në Kodrën e Minatorëve në Mitrovicë”* (kodri i projektit 18493).

PYETJA: Çfarë keni bërë për këtë projekt deri më tani?



NUMERI I PROJEKUT: 0612961/196-1540
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPŠTINA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
ASSEMBLY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO
Kodi për Projektin në bazë të procedurës administrative të Prirëseje i Presidencës-Table 01
Titulli i Propozimit: 05.03.2019
Prost. NO. 2019

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR / ZA / TO	z. Pal Lekaj, Ministër i Infrastrukturës dhe Transportit	DATE DATUM DATE	04.03.2019
		Reference	
NGA / OD / FROM	Avdullah Hoti Kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje parlamentare për përgjigje me shkrim		

Në bazë të Nenit 46 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, shtroj pyetje parlamentare për përgjigje me shkrim nga z. Pal Lekaj-Ministër i Infrastrukturës dhe Transportit

Çështja:

Me propozim të Grupit Parlamentar të LDK-së, në buxhetin e vitit 2018 dhe 2019 është përfshirë projekti për Mitrovicën Veriore lidhur me rrugën "Sami Frashëri" në gjatësi prej 300 m. Emri i projektit i përfshirë në buxhetin 2019 është "Asfaltimi i rrugës Sami Frashëri, në gjatësi prej 300 metra, në Mitrovicën Veriore" (kodi i projektit 15762).

Rruga "Sami Frashëri" është e vetmja rrugë në Mitrovicën Veriore e banuar nga shqiptarët dhe nuk është e asfaltuar. Shuma që kërkohet nuk është e madhe dhe ky projekt ka qenë i përfshirë edhe në buxhetin e vitit 2018 por që nuk është realizuar.

PYETJA: Ku ka arritur ky projekt deri më tani?